Menyra se si kuantit energjistik perbashkohet rreth vetes duke cuar ne formimin e grimcave elementare eshte nje proces i panjohur akoma, por ekzistenca e faktoreve jashtekuantike nuk duhet anashkaluar si e padobishme (ne kete pike parimi i shkakat te formimit te levizjes drejt nje forme te re cilesore e permbledhe edhe kete pike veshtiresisht te panjohur), cka do te thote se ekzistenca e kuantit energjistik eshte e bashkerendur edhe me ambientin ku ai jeton. Kjo e fundit duhet konsideruar e qene ne te gjithete shkallet e organizimit te mevonshem te formave te Lendes dhe produkteve te saj, por dhe si nje menyre se si bashkejetojne dy forma cilesisht te ndryshme ne planin aplikativ (ne kete pozicion te organizimit te lendes merr rendesi Raporti kohor-hapsinor si formule filozofike qe shpjegon shkaqet dhe pasojat e zhvillimit te dukurive NATYRORE dhe formave qe rrjedhin prej saj, per rastin konkret te Lendes). Ka shume mundesi qe forma formuese e nje cilesie te re lendore te jete ambienti ku jeton dhe vete kjo forme e re cilesore, por pa qene asnjehere si ajo, e cila tek Bota Njerezore eshte shume evidente, ambienti i se ciles eshte e barabarte me te gjithete format cilesore lendore paraardhese. Kjo ben qe rrugeshvillimi i metejshe i tyre te jete i ndryshem edhe pse dikur ato mund te kene qene ne te njejtin stad zhvillimi cilesor. Ne kete rast qofte koha, qofte hapesira njerezore eshte e mbihypur mbi kohen dhe hapesirat paraardhese duke qene te ndryshme prej tyre, por duke bashkejetuar secila per hesap te vet. Formalisht njeriu mund te ndikojte mbi to, por sa me larg prej tyre te jete nga pikepamja kohore aq me i pamundur eshte ky ndikim dhe ky formalizem (permasa e ketij formalizmi duhet te argumentojte dhe distancen kohore qe ndan njeriu nga format e organizimit te Lendes dhe format paraardhese te Levizjes).

Grimca elementare duhet te perbeje rrugeshvillimin e levizjes fizike dhe rrugeshformimin e thelbit te dukshem te Lendes. Kjo e fundit vetem tani duhet konsideruar e lindur, por argumentueshem e varur, nga pikepamja hapsinore, nga bashkesia e kuanteve te emergjise, qe ne kete rast duket sikur perfaqesojne fushe. Ne realitet fushat e mevonshme qe dallohen si bashkeshoqerues te Lendes (fushat manjetike, fushat elektromagnetike, fushat e gravitetit, rrymat parazitare) nuk duhet te kene lidhje me kete pozicion fillestar te organizimit te Lendes. E rendesishme eshte te kuptohet qe formimi i te gjithete grimcave te mevonshme elementare duhet t'i dedikohet marredhenieve te grimces se pare me ambientin kuantik rrethues. I takon shkences te percaktoje se kush nga tre grimcat elementare (proton, elektron, neutron) eshte formuar e para, por filozofia materialiste e cvesh neutronin nga kjo gare pasi mungesa e tij ne berthamen e hidrogjenit duhet te sherbeje si argument qe berthama e hidrogjenit eshte formuar perpara kohes se formimit e neutronit. Normalisht radha e formimit te grimcave elementare duhet te percaktohet mbi bazen e vetive specifike dhe ne raportin qe ate kundrejt njera-tjetres. Ne kete menyre duhet pranuar qe protoni eshte formuar i pari dhe rreth tij eshte pasuruar berthama. Duhet te ekzistojte nje faze kohore ku berthama e ardhshme e atomit te kete jetuar e vetme dhe komplikacioni i saj t'i jete nenshtruar nje procesi pasurimi dhe marredheniesh me ambientin rrethues, proces i cili ka cuar ne formimin e elektronit dhe ne atomin e pare te historise se Lendes. Prosesi i formimit te atomit te Hidrogjenit nuk duhet konsideruar si fillimi i lendes, por si kalimi i fushave kuantike drejt komplikacionit perfundimtar, mbi cbase formohet neutroni. Une nuk jam ne gjendje te ndjek rrugeshformimin e grimcave te tjera (pozitroni, neutrinoja, etj), por nuk duhet te jete e veshtire percaktimi i rrugeshformimit te tyre po te njihen vetite perkatese. Duke e thjeshtuar problemin ne ekzistencen vetem te tre grimcave elementare, e gjithete historia e ketyre grimcave rrotullohet ne kombinimet e tyre dhe ne bashkeveprimin me fushat kuantike mbi c'base ato shtohen ne sasi duke formuar atome te reja cilesore drejt elementeve kimike. I gjithete procesi gjigand i veprimtarise se fushave kuantike drejt grimcave elementare perben boten e madhe fizike te formimit te lendes drejt permbajtjes se sotme te saj. I gjithete ky proces kosiston ne shtimin e elektroneve ne orbite, te protonit dhe neutronit ne berthame. Permasat e shumta te levizjes fizike ne kete proces, duhet te coje ne konkluzionin qe koha fizike duhet te kete qene shume-shume e konsiderueshme ne planin aplikativ duke e perjashtuar idene e 100 sekondave te pare te Bing-Bengut si kohe te mjaftueshme per formimin e elementeve kimike (ideja e Stephen Hawkingut). Megjithate duhet te pranojme qe Levizja Fizike bashkeshoqerohet gjate gjithete kohes se ekzistences se vet nga levizja mekanike si pjese e saj, krejt e ndryshme nga levizja mekanike e epokes kuantike (kjo faze e zhvillimit te Lendes duhet konsideruar pergjegjese per lindjen e Gravitetit dhe formimin perfundimtar te Lendes.

Rendesia ka qe studiuesi i kesaj fushe duhet te kuptojte keto probleme paraprake perpara se te avancoje ne thellesite e njohjes fizike:

- 1- Karakteri shkakesor dypermasor i levizjes fizike ne te gjitha nivelet e saj.
- 2- dinamikën e brendeshme te kuantit energjistik.
- 3- marredheniet e kuantit me ambientin rrethues.
- 4- perberjen e grimcave elementare nga keto kuantite.
- 5- marredheniet e ketyre grimcave me ambientin kuantik.
- 6- marredheniet e ketyre grimcave midis tyre brenda nje orbite dhe midis orbitave (rasti i elektronit).
- 7- marredheniet e grimcave me berthamen dhe brenda saj (rasti i protonit).

8- marredheniet e grimcave cilesore midis tyre, brenda berthames (rasti i protonit dhe neutronit).

9- Marredheniet e grimcave cilesore midis tyre, pamvaresisht nga vendndodhja e tyre (rast i elektronit me protonin apo neutronin).

Jane te gjitha keto marredhenie shumepermasore dhe gjendja e grimcave elementare qe cojne ne cilesine formuese te elementeve kimike pergjate nje procesi fizik teper-teper te konsiderueshem nga pikepamja kohore, ku marredheniet midis elementeve kimike duhet te kene qene me te hershme se perfundimi kohor i formimit te elementeve kimike, sidomos midis elementeve te pare. Kjo do te thote se uji duhet te jete formuar me perpara se elementi i uraniumit p.sh., por ne kete pike problemi behet pak me i komplikuar pasi duhet zgjidhur si nje rast vetem tokesor, apo i pergjithshem (ne kete rast kemi ezauruar njerin prej mundesive te lindjes se jetes ne Toke; ne qofte se rasti i formimit te ujit eshte vetem tokesor, atehere eshte e kuptueshme qe kemi gjetur aresyen primare te jetes ne Toke, ne te kunderten duhet te avancojme me tej drejt te panjohurave). Ekzistenca e disa elementeve kimike me vecori fizike te ndryshme (radioaktiviteti), te cilet ndodhen ne fund te tabelës se Mendelejevit, me ka cuar ne perfundimin se procesi i transformimit te elementeve kimike behet pikerisht me ane te radioaktivitetit dhe detyrimisht te gjithë elementet kimike do ta mbyllin jeten e tyre duke u bere ne fund radioaktive, perpara se te ndahen ne elemente me te thjeshte kimike (kjo mund te perforcohet edhe me ane te radioaktivitetit artificial te te gjithë elementave kimike). Vete procesi i transformimit te elementeve kimike radioaktive pergjate faktorit kohe eshte i mjaftueshem per te percaktuar ne menyre empirike kohen e formimit te elementeve kimike.

Me marredheniet e elementeve kimike midis tyre futemi ne levizjen kimike, qe perben dhe thelbin e Lendes ne perberjen e saj. Ne qofte se pranojme qe levizja mekanike con medoemos drejt levizjes fizike dhe levizja fizike con ne levizjen kimike, atehere thelbin i Lendes e perben levizja kimike dhe ky eshte argumenti me i pare qe format e Lendes jane ne unitet dhe rrjedhin nga njera-tjetra. Interesant eshte fakti qe bota e njohjes Njerezore e ka filluar veprimtarine e vet pikerisht nga ky stad i zhvillimit te formave te levizjes dhe kjo e ka nje domethenie te lidhur me empirizmin, formalizmin, formen filozofike dhe shkallen e zhvillimit shoqeror. Levizja kimike i permban ne brendesi te vet te gjitha format e levizjeve paraardhese duke bashkevepruar ne menyre te domosdoshme, por ne kete pike ne kemi konstatimin e pare qe format me te thjeshta te levizjes nuk ndikojne domosdoshmerisht mbi format me te larta, cka te con ne perfundimin qe forma mekanike ne levizjen kimike ndryshon cilesisht nga levizje mekanike e kahershme jo vetem ne forme, por kryesisht ne permbajtje. Ne kete faze te zhvillimit te materies Lendore dallohen cilesite specifike te organizimit te formave te Lendes dhe mundesite e zbulimit te tyre duke perfshire edhe me te komplikuarat. Kjo forme levizje eshte forma me pergjithesuese e ishullit tone Lendor dhe forma ku ndahet ZOTI nga NJERIU. Eshte pika me e veshtire e shkencave te natyres pasi ne kete pike fillon nje forme e re e Historise se Natyres Lendore. Vazhdimi i metejshe i levizjes kimike kerkon parapakisht njohjen e ketyre elementeve te zhvillimit te Natyres Lendore:

1 – karakteri shkakesor dypermasor i levizjes kimike ne te gjitha nivelet e saj.

2 – dinamiken e brendeshme te atomit.

3 – marredheniet e atomit me ambientin rrethues.

4 – perberja e atomeve nga grimcat elementare.

5 - marredheniet e ketyre atomave me ambientin kuantik dhe grimcor elementar.

6 – marredheniet e ketyre atomeve midis tyre brenda nje elementi kimik dhe midis elementave kimike cilesor

7 – marredheniet e bashkesive atomike brenda llojit dhe midis llojeve.

8 – krijimin e molekules kimike.

9 – krijimin e substanceve kimike.

Deri ne kete pike shkenca ka arritur perfundime te rendesishme dhe pergjithesisht njohja njerezore e ka kryer detyren e vet konform nevojave praktike te njerezimit. Por shkenca e gjeologjise ka bere nje kapercim serioz ne shpjegimin e perberjes kimike te shkembinjve: nuk ka qene e afte te shpjegoje zanafillen e ndarjes se substancave te thjeshta kimike nga ato organike, pasi rezulton qe bota e relacioneve kimike brenda botes se vet nuk eshte e afte te shpjegoje diferencimin cilesor midis substances me te komplikuar kimike te thjeshte me substancën me te thjeshte te kimise organike. Cfare ka ndodhur ne brendesi te levizjes kimike kur ajo vendosi t'i jape nje vend te posacem trinomit, kuantitetit dhe pentetetit kimik ekuacional: $H + O + C + (S) + (N)$ duke i kombinuar ne "pafundesit" drejt molekules se pare organike? Kjo gje duhet kerkuar tek marredheniet shumepaleshe brenda botes kimike dhe lidhjes se saj me boten fizike dhe mekanike. Fakti qe ne Boten Kozmike, thjeshte ne sistemin tone Diellor, nuk gjende forma te tjera organike, te detyron ta kerkosh procesin e formimit te substancave organike tek nje rastesi ekstreme te marredhenieve shumepaleshe te formave te deriatehershme te Lendes dhe formave te Levizjes. Kjo pike rezulton te jete me e pazberthyeshmja ne shkencen e kimise, por dhe praku ku fillon levizja biologjike. Keshtu qe ne kete drejtim filozofi materialist duhet te heshte per shkak te nivelit te ulet te njohjes aktuale. Por mungesa e nje elementi kimik ne Toke dhe pranimi i zhvillimit heterogjen te natyres kimike mund te na coje ne nje perfundim te ri mbi kalimin e lidhjeve inorganike ne lidhjet organike, mbi cbaze fillon jeta biologjike ne Toke, e cila ne planin e pergjithshem galaktit duhet konsideruar nje rastesi ekstreme. Per deri sa ne nuk dime se cfare behet ne sistemet e tjera diellore, brenda Galaktikes sone, jemi te detyruar te kufizohemi brenda kesaj hipoteze, qe gjithsesi nuk ndikon mbi jeten tone ne Toke. Por analiza e levizjes kimiko-organike ka brenda "misterin" e shumefishimit specifik te botes se mepastajme dhe eshte kjo aresyeja perse i duhet dhene rendesi zbulimit te fillimit te levizjes organike te kimise. Ekuacionet e mepastajme te transformimit te strukturave kimiko-organike drejt botes njerezore jane shume me te kuptueshme dhe brenda nje hapësire transformuese te lexueshme edhe pse ato fshehin mistere te jashtezakonshme drejt pafundesise. Mire eshte te pranohet heterogjeniteti shumepermasor te perbere nga nje sasi ekuacionesh kalimtare te perbere nga dinamika e brendeshme e bashkerenduar nga ambienti rrethues. Permasat e kesaj te fundit duhet te konsiderohen edhe rastesore mbi cbaze kane lindur mutacione pa domethenie ne vazhdimesine drejt boteve me te komplikuar.

Akti i pare i kesaj hapësire trasformuese duhet konsideruar struktura e pare kimiko-organike dhe kjo eshte e vetmja

strukture e ketij lloji qe njohim ne hapersiren e pafundme kozmike, qe gjithsesi duhet konsideruar si i vetmi burim lendor i botes se ardhshme njerezore (spekullimet qe behen mbi ardhjen e jashtetokesoreve si inicues te jetes njerezore ne Toke nuk eshte veshtire t'i permbyesesh). Eshte kjo aresyeja qe praktikisht bota njerezore konsiderohet si forma me e larte e organizimit te Lendes.

Problemi i kalimit te substancave organike ne boten biologjike nuk duhet te jete dhe fort i veshtire te zberthehet vetem se studiuesit e kesaj fushe kane bere kapercime serioze duke i anashkaluar si inekzistente. Gjeja me kryesore ne boten organike eshte permasa e shumefishimit brenda llojit cilesor dhe krijimi i cilesoreve te rinj organike. N.q.s. per boten kimike inorganike ky problem ka nje variacion kohor teper-teper te gjate, per vazhdimesine e botes biologjike problemi eshte shume sinjifikativ duke perbere nje ndryshueshmeri cilesore teper te theksuar ne raport me te paren. Ne kete pike gjerat bien ne sy dukshem dhe cuditerisht nuk ka pasur reagime ne fushen shkencore per kete problem (permasa e kohes eshte konsideruar e rendesishme vetem brenda kuadrit te ekzistences dhe jo me shume). Megjithate ekziston nje pozicion ndermjetes shumepermator ku faktori koheeksistence fillon te sfumohet ne te kundert pa nxjerre asnje perfitim konkret. Ne kete drejtim shkences i takon te beje disa sakesime per ta pare problemin pikerisht ne drejtim te koheeksistences, cka duhet te coje te zbulimin me rrenjesor te zanafilles te seicilit element te ekuacionit duke filluar nga substancat organike – njeqelizori botanik – shumeqelizori botanik – bimet. Vete keto te fundit perbejne nje komplikacion te cuditshem ne drejtim te menyres se jeteses dhe shumimit, pasi perfundimi eshte me te vertete i jashtezakonshem me ekzistencen e bimeve mishngrenese. Problemi duhet shtruar: dinamika cilesore e botes botanike vazhdon pergjate kohes se ekzistences se botes zoologjike dhe asaj njerezore (ne fakt kjo duhet pranuar per te gjitha botet paraardhese dhe ketu qendron thelbi i unitetit te NATYRES (Materies)). Materialisti nuk mund te pranoje frenimin apo perfundimin e zhvillimit cilesor te produktit apo nenproduktit lendor te krijuar perpara Njeriut. Ne qofte se pranojme qe Njeriu eshte forma me e larte e organizimit te Lendes, atehere me Njeriun merr fund llojshmeria e organizimit te Lendes. Kjo dukuri ka pasur nje veshtiresi ne perceptim nga ana e studiusve te fushava te ndryshme te lidhur me mos marrjen ne konsiderate te nje parametri shume-shume percaktues te cilesine dhe sasine e boteve biologjike, zoologjike dhe njerezore: shpejtesise se zhvillimit specifik (te pakten kjo bie ne sy ne teorine e prejardhjes se llojeve me ane te seleksionimit natyror ose ruajtjes se racave me te pershtatura ne lufte per jeten te Çarlz Darvinit (1809 – 1882), Tirane 1982, por autori i teorise kishte bere edhe nje hap me perpara negativ ne mohimin e faktorit KOHE ne procesin e seleksionimit natyror duke vene ne pikepyetje, deri ne mohim, te gjitha teorine e tij). Rendesia e shpejtesise se zhvillimit specifik te te gjitha formave te NATURES do te duket shume-shume me vone, atehere, kur te cfaqet Shoqeria Njerezore dhe parametri Shpejtesi Zhvillimi do te behet strumbullari i te gjitha jetes Njerezore ne Toke, por dhe ajo qe nuk eshte kuptuar asnjehere prej 2500 vjetesh: percaktimin e kesaj shpejtesie nga KOHA e lindjes. Kjo e fundit ka vlera per te gjitha shkallet e zhvillimit te formave te fundme te NATYRES (Lendes) dhe eshte e pavlefshme per vete NATYREN (eshte kjo aresyeja perse NATYRA nuk ka kufizim ne shpejtesi).

Analiza e metejshe me e levizjes biologjike (pjesa botanike) kerkon medoemos njohjen e proceseve specifike ne nivelet e meposhtme, perpara se te futemi ne thellesite e botes biologjike:

- 1 – karakteri shkakesor dypermator i levizjes botanike ne te gjitha nivelet e saj.
- 2 – dinamiken e brendeshme te njeqelizoreve botanike.
- 3 – marredheniet e ketij njeqelizori me ambientin rrethues organik e inorganik.
- 4 – marredheniet e ketyre njeqelizoreve midis tyre brenda nje bime dhe midis bimeve te ndryshme
- 5 – krijimin e shumeqelizorit botanik.
- 6 – marredheniet e shumeqelizorit botanik me ambientin rrethues kimik te te gjitha niveleve.
- 7 – marredheniet e shumeqelizoreve botanik brenda llojit dhe midis llojeve.
- 8 – krijimin e organeve jetesore te bimeve.
- 9 – krijimin e bimes

Levizja botanike karakterizohet nga bashkesia e te gjitha formave paraardhese te levizjes dhe nuk mund te ekzistojte dot pa kete bashkesi. Te pakten kjo e fundit dallohet lehtesisht tek bimet dhe kjo ne saje te kohes teper te kufizuar te ekzistences individuale se tyre. Me levizjen botanike ndryshon i gjitha konfigurimi i formave te metejshe me organizimit te Lendes ne planin sasior dhe cilesor jo vetem me pjesemarrjen e nje pjese teper – teper te vogel te hapesires lendore, por dhe te kohes teper – teper te kufizuar te ekzistences se saj ne raport me format paraardhese. Me levizjen botanike bie ne sy ndryshimi teper cilesor i formave organizative lendore dhe pikepyetja e madhe se cfare perfaqeson ajo ne dinamiken jetesore te Lendes. Mbi kete forme te levizjes fillon jeten e vet nje ekuacion hapesor teper – teper specifik per natyren Lendore ku ndryshimi cilesor i elementeve perberes te tij karakterizohet nga ndryshime teper te shpejta ne KOHE ne raport me te gjitha levizjet e parapara. Behet fjale per levizjen biologjike qe permban ne vetvete keto kohe/hapesira: botanika – zoologjia – shoqeria njerezore. Por levizja botanike do te karakterizohej edhe nga nje vecori: do te perbehej nga lloje me koheeksistence ekstremiste (bimet dhe pemet) cka duhet te sherbeje per te treguar argumentueshem menyren e formimit ekstremist te tyre nga pikepamja kohore dhe ndoshta paralel per nje fare kohe me strukturat zoologjike. Ne kete pike duhet te qendroje nje nder pikat me te fshehta te zanafilles botanike dhe zoologjike e pse jo edhe njerezore. Bota botanike do te kishte edhe nje vecori tjeter: shumefishimi cilesor i saj do te ishte krejt rastesor (do te varej nga nje variant i levizjes mekanike) dhe per kete shkak numri i llojeve te hapesires biologjike do te ishte i kufizuar. Ajo do te kishte edhe nje vecori tjeter: do te zhvillohej ne siperfaqen e tokes me ndihmen e ujit. Ne kete pike, uji do te rezultonte si njeri nder shkaqet kryesore te zhvillimit te botes botanike qe nga casti i lindjes se saj dhe promotori i kalimit te botes botanike ne bote zoologjike pa i humbur permaset e veta. Relacionet shumepermator te Botes Botanike midis vetes, me ambientin organik kimik, me ate inorganik, me ambientin fizik dhe mekanik con ne lindjen e qelizes se pare zoologjike. Lindja e Botes Zoologjike i duhet dedikuar pikerisht relacioneve shumepermator te Botes Botanike dhe aspak nje ardhjeje jashtetokesore. Kjo e fundit mund te pranohej vetem per rastin e gjetjes se nje bote me te zhvilluar me vazhdimesi pertej diteve tona duke perfshire edhe aktualitetin historik, te pakten ne keto 100 000 (me

hamendje) vitet e fundit.

Kalimi i botes botanike ne bote zoologjike duhet konsideruar shume here me rastesore se vazhdimesia e metejshme e botes zoologjike ne boten njerezore dhe kjo per shkak te pjesmarrjes se levizjes mekanike me permasa shume me te vogla se pasardhesja zoologjike. I them te gjitha keto per te kuptuar veshtiresite natyrore te kalimeve cilesore nga bota inorganike drejt botes zoologjike. Vete Bota Zoologjike per t'u kuptuar saktesisht kerkon paraprakisht njohjen e fenomeneve te meposhtme sipas nje dinamike jo pak te rendesishme:

- 1 – karakteri shkakesor dypermasor i levizjes zoologjike ne te gjitha nivelet e saj.
- 2 – dinamiken e brendeshme te njeqelizoreve zoologjike.
- 3 – marredheniet e ketij njeqelizori me ambientin rrethues botanik dhe kimik ne te gjitha permasen.
- 4 – marredheniet e ketyre njeqelizoreve zoologjike midis tyre
- 5 – krijimin e shumeqelizorit zoologjik.
- 6 – marredheniet e shumeqelizorit zoologjik me ambientin rrethues botanik dhe atij kimik ne te gjitha nivelet
- 7 – marredheniet e shumeqelizoreve zoologjike brenda llojit dhe midis llojeve.
- 8 – krijimin e organeve jetesore te qenieve vetelevizese.
- 9 – krijimin e qenieve te para zoologjike.

Bota Zoologjike paraqitet shume me e komplikuar se bota botanike edhe vetem prej faktit te levizjes mekanike te strukturave te saj me permasa shume-shume me te medha dhe te domosdoshme. Ne kete menyre ajo duhet te cfaqet keto komplikacione edhe ne strukturen vetiakte dhe grupore. Kjo te con ne perfundimin qe shumellojshmeria e botes zoologjike duhet te jete shume here me e madhe se ajo e botes botanike dhe ne kete shumellojshmeri duhet vecuar aftesia e riprodhimit te tyre. Krijimi i duetit femer-mashkull dhe bashkejtesa ne nje familje, mbi cbaze krijohet riprodhimi i tyre, nuk duhet te jete nje fenomen kaq thjeshte i konstatareshem, por veshtiresisht i argumentueshem. Ne kete faze te zhvillimit te botes zoologjike kjo pothuajse eshte e pamundur dhe duhet nje hallke e metejshme zhvillimi per te kuptuar aresyet natyrore te kalimit nga struktura zoologjike monoseksuale ne dy seksualitetin e nevojshem zoologjik. Menyra se si eshte shtruar ky problem sipas menyres alegorike: kush ka lindur me perpara veza apo pula, tregon qe ky problem eshte tej mases i komplikuar dhe nuk ka asnje argument qe te lejon zbulimin e saj ne kete faze te konstatimit, por dhe paafesine e shkences se zoologjise per t'i dhene nje pergjigje te sakte. Eshte pikerisht pika ku Feja dhe Shkenca nuk jane kontraktuar ndonjehere dhe kjo thjeshte per paafesine te Shkences dhe Filozofise (interesant eshte fakti qe te vetequajturit ateiste nuk e kane vene ne dukje kete problem) cka me ka cuar ne perfundimin se te dy keto veprimtari njerezore ne fushen e subjektit kane boshlleqe serioze qe duhen plotesuar. Kam rast te jap nje shpjegim me konkret te ketij problemi te mbeshtetur ne FAKTE, por qe jane anashkaluar edhe pse vihen re per dite ne miliona raste.

Ndarja e botes zoologjike ne krijesa te tokes dhe te detit nuk e ka fshehur faktin e te qenurit te detit si shtepia e te pares krijese zoologjike ne historine e Lendes ne Toke. Ne ambientin ujqor duhet kerkuar moshja me e vjeter e ekzistences se botes zoologjike dhe aresyet e kalimit te jetes se qenieve vetelevizese nga uji ne toke. Perseri ne kete pike problemet jane jashtezakonisht te veshtira, por dhe nje argument per te parashikuar kalimin e Njeriut nga Toka ne Uje si menyre jetese. Prejardhja e larget e Njeriut nga bota ujore duhet te jete bere nepermjet nje seri shkalles te njepasnjeshme dhe per te percaktuar keto shkalle duhet futur ne perdorim faktori KOHE, i cili duhet te percaktoje aresyet perse ka ndodhur ky kalim. Me zbulimet e derisotme shkenca e Zoologjise duhet te jete e afte per te percaktuar dallimet cilesore midis qenieve te gjalla detare nga ato tokesore (bota e zvaranikeve nuk duhet pare si mutacion, por si nje faze kalimtare nga qeniet e detit ne ato te tokes. Ka shume mundesi qe moshja e peshkaqeneve dhe e balenave te jete me e vogel se moshja e kafsheve te pare te Tokes. Karakteri heterogjen i ketij kalimi dhe zhvillimi duhet te konsiderohet si shkaku i shumellojshmerise se kafsheve te Tokes pa pasur nevojte per nje prejardhje nga nje forme e vetme fillestare. Po te shihet nga ana kohore ky problem nuk do te jete e veshtire konstatimi i parimit poligenetik te formimit te kafsheve te Tokes ane e kend globit. Karakteri monogjenetik i lindjes se llojeve ne levizjen zoologjike duhet marre ne konsiderate per siperfaqe toke, apo deti, teper te kufizuara dhe pa ndryshime te medha klimaterike, topografike e botanike, pasi mbi keto ndryshime ndodh dhe lindja e llojit te ri si pershtatje me realitetin. Nje raport midis botes botanike dhe asaj zoologjike eshte i pamundur te ndertohet me dijet e derisotme, pasi ndryshimi cilesor midis tyre eshte jashtezakonisht i madh dhe hopet kalimtare nga bota bimore ne ate shtazore nuk e di a jane zbuluar te gjitha. Kjo nuk duhet te pengojte pranimin a priori te rrjedhjes se botes shtazore nga bota bimore dhe kalimin ne nje shkalle edhe me te larte te levizjes biologjike drejt botes njerezore. Une pretendoj qe kalimi nga bota e kafsheve ne bote njerezore nuk eshte e veshtire te argumentohet edhe vetem mbi baza biologjike, ku anatomia e Njeriut me ate kafsheve ka pika te medha kontakti dhe i vetmi ndryshim i tyre qendronte ne veprimtarite mbi Natyren (njeriu prodhonte, ndersa kafsha maksimumi mblidhte).

Njeriu nuk perfaqeson vetem nje specie me ndryshim cilesor nga prejardhja e vet zoologjike. Kryesorja e Njeriut eshte ekzistenca e tij si forma me e larte e organizimit te te vetmes forme qe njohim te NATYRES e lidhur me menyren e levizjes. Po te shohim detyrat qe duhet te realizojte studiuesi per te gjitha rastet e formave te organizimit te Lendes drejt Njeriut veme re se bota kuantike ngjason me boten e njeriut cka te con ne perfundimin se kemi te bejme me dy ekstremet e botes Lendore dhe detyrimisht, sipas parimit dialektik, ato duhet te perputhen. Qe te mundesh te kuptosh mire Boten Njerezore duhen zberthyer:

- 1 – karakteri shkakesor shumepermasor i levizjes shoqerore ne te gjitha nivelet e saj.
- 2 – dinamika e brendeshme te njeriut shoqeror nga pikepamja individuale (parimi i ekzistences dhe i punes).
- 3 – marredheniet e ketij individi me ambientin rrethues zoologjik, botanik dhe kimik ne te gjitha permasen.
- 4 – marredheniet e ketyre individeve shoqeror midis tyre (lindja e gjuhes se folur).
- 5 – krijimi i Shoqerise Njerezore.

6 – marrëdhëniet e Shoqërisë Njerezore me ambientin rrethues zoologjik, botanik dhe atij kimik në të gjithë nivelet (parimi i punës kolektive).

7 – marrëdhëniet e Shoqërisë Njerezore brenda saj dhe midis llojeve (racave) (bota e relacioneve universale dhe permasat e saj).

8 – krijimi i Fesë dhe Institucioneve fetare (rasti i gjysem-shtetit fisnor); - çfarë ka realizuar institucioni fetar në historinë e Njerezimit dhe perse kanë shërbyer ato.

9 – krijimi i organeve jetësore të Shoqërisë Njerezore (rasti i familjes, prones fisnore, të drejtës zakonore të pashkruar; krijimi i shtetit).

Të gjitha këto kanë nevojë për një zberthim universal përpara se t'i japim përgjigje pyetjes: perse NATYRA e ka krijuar Njeriun dhe perse njeriu ekziston vetëm në formën e Bashkësisë Njerezore që nga dita e formimit të tij me të parë (në këtë drejtim, procesi i bashkësisë duhet të jetë huazuar nga bota e kafshëve dhe pikerisht këtë bashkësi komandon ZOTI). Pikerisht në këtë pikë duhet të fillojë zberthimi i Shoqërisë Njerezore duke pranuar parimin poligjenetik të lindjes së tij në Globin Tokësor, por dhe pikerisht në këtë pikë fillojnë gabimet e njepasnëshme të mendimit filozofik botëror që e kanë kanalizuar Njerezimin drejt njëshiti iluzor. Përcaktimi i parimit natyror të lindjes së njeriut në Tokë ka të bëjë shumë me parimin e zhvillimit të Shoqërisë Njerezore në Tokë, por dhe fshehjen e parametrit absolut të zhvillimit sipas kontinuitetit kohor-hapsinor. Marrja në konsideratë vetëm të hapsirës përgjate mijeravjeteve e ka devijuar mendimin shkencor drejt kanaleve shterp ku jo rrallë herë mendimi i gabuar ka sunduar për një kohë të gjatë. Parimi poligjenetik i lindjes së Njeriut në Tokë përbën diferencim racor, por shkallë të ndryshme zhvillimi që janë prezent edhe brenda një race deri në atë masë se raca e bardhë që drejton përgjithësisht politiken botërore ka në brendësi të vet dhe popullin më inferior në bote, që edhe pse është udhëhequr nga shtetet me të fuqishme të kohës përgjate 2500 vjetëve ka mbetur akoma populli më primitiv i kontinentit të bardhë. Parimi poligjenetik i lindjes së Njeriut në Tokë fsheh edhe problemin më kryesor të Historisë së Njerezimit: mënyrën se si ndryshon Njeriu dhe Popujt e Botes në sajë të relacioneve universale. Kjo e fundit përben të gjithë thelbin e arsyes përse poligjeneza është i vetmi parim i lindjes së qenieve të gjalla në Tokë. Një ndër problemet kryesore të qenieve të gjalla në Tokë është ai i krijimit të dualitetit seksual, kur dime që parimi monoseksual është shoqëruesi i krijimit të gjallesave me të para. Në këtë drejtim shkencë ka heshtur dhe nuk ka folur kurrë. Vetëm mendimi filozofik fetar ka dhënë deduksionet e veta duke nxjerrë të zbuluar kohën e të shkruajturit qoftë të Biblës e qoftë të Kuranit. Jashtë filozofisë fetare, mendimi filozofik botëror ka tentuar të shpjegojë jo mënyrën e lindjes së qenieve të gjalla nga pikepamja seksuale, por vetëm arsyes të diferencimit shoqëror midis seksëve (të pakten libri i Frederik Engelsit mbi origjinën e familjes, prones private dhe e shtetit, apo i Karl Gustaf Jung, "Aspekte të Mashkullores" e perligjin këtë pretendim). Pasi u mora me këtë problem vura re se ai nuk zgjidhë tek format e ulta të gjallesave, por kur erdhi puna tek Njeriu vura re se mungonte një parameter në analizën e Botes Njerezore dhe ishte pikerisht ky parameter ai që e fshihte gjenezën e njeriut nga pikepamja seksuale (është kjo arsyeja përse "Dialektika Filozofike" (Hegeli) dhe "Paradoksi i Kohës" (Ajnshtajni) nuk mund të zbuloheshin jashtë botes Njerezore; në të kundërtën ato do të kishin adresime të gabuara). Analiza e shpejtesisë së zhvillimit social tek individë njeri tregonte se njeriu individual e kishte këtë parameter më ndryshueshmeri vlerë dhe kjo kishte ndodhur e trashëguar që nga bota nga Njeriu kishte prejardhjen e largët. Në këtë mënyrë zgjidhja e problemit të mënyrës së lindjes së seksëve në Botën Njerezore ishte në të njëjtën kohë dhe zgjidhja e problemit për qeniet e gjalla jashtë botes njerezore. Duke u mbështetur tek Bibla dhe Kurani, rezultoi se mashkulli ka lindur përpara femrës nga pikepamja kohore. Në këtë pikë problemi sipas kohës kishte anashkuar thelbin e ngjarjes pasi nuk bëhej fjale kush kishte lindur më përpara, por nga rrjedhën qoftë femra, qoftë mashkulli dhe këtë e zgjidhte FAKTI historik i individit (i femrës dhe i mashkullit) që dihet shumë saktë, por që nuk ishte ditur të interpretohej prej mijeravjetësh. Problemi shtrohet: si janë formuar gjallesat nga pikepamja seksuale? Ai zgjidhet duke bashkuar FAKTIN me raportin kohor-hapsinor dhe rrjedhimet që dalin prej tij dhe dukuria mërr spunto vetëm nga bota njerezore duke u përgjithësuar edhe për gjallasat nga e ka prejardhjen biologjike Njeriu.

Faktet janë dy grupimesh të lidhur me raportin e moshave të aftësisë riprodhuese dhe jetëgjatësisë e procesit (njeriu femër këtë aftësi e fiton përgjithësisht që në moshën 13-14 vjeç, kur mashkulli këtë aftësi e fiton disa vjet më vonë, por tek femra aftësia riprodhuese shteron përgjithësisht që në moshën 50 vjeçare, kur tek mashkulli vazhdon përtej moshës së tretë) si dhe me raportin e moshave në aftësi intelektuale për të ndryshuar Natyrën (femra këtë aftësi e fiton përpara mashkullit disa vjet duke u frenuar në moshën kur mashkulli sapo e fillon aftësinë e ndryshimit të Natyrës). Ky karambol dhe kjo mosperputhje me rrjedhimet e raportit kohor-hapsinor ka vetëm një shpjegim: për të kapërcyer paaftësinë e gjallasave për t'u riprodhuar nga vetvetja (arsyeja e kesaj pamundesie përben argumentin për të parashkuar ekzistencën e një ndryshimi cilesor në ecurinë e jetës së gjallesave të atyre koherave para milionvjetëve, çka ka cuar në ndryshimin e shpejtesisë së zhvillimit specifik NATYRA urdheroi ndryshimin e procesit duke e detyruar gjallesën monoseksuale të transformohej në femër dhe vetë kjo femër të prodhonte mashkullin. Se si ka ndodhur biologjikisht ky proces për mua është e pamundur ta interpretoj, por kur vjen puna për të përcaktuar se kush ka lindur më përpara pula apo veza, raporti kohor-hapsinor postulon që pula është paresore në kohë dhe veza produkt i saj, pasi shumëfishimi i paraardhësve të pulës nuk ka pasur nevojë për partner. Ndoshta procesi i ekzistencës së vezës mund të ndihmojë në zbulimin e procesit të kalimit nga monoseksualizmi biologjik në atë dy seksual. I gjithë ky proces ke cuar në lindjen e një ndjenje, që nuk ekziston vetëm tek njeriu: ndjenjen e Nenes për femijën e vet. Është e vetmja ndjenje në psikologjinë e Njeriut pa interes dhe e trashëguar nga bota paraardhëse e tij.

Por ky problem zgjerohet edhe më tej kur vjen puna për të përcaktuar llojet e familjeve në racën njerezore në Tokë nga pikepamja e transformimit. Në librin e F.Engelsit ky proces nuk është marrë parasysh, pasi është pranuar vetëm ekzistenca e llojeve pa e prekur shkakun e drejtepërdrejtë (në fakt marksizmi e nenkuptoi këtë shkak brenda hapësirës ekonomike duke anashkuar përgjegjësinë faktike). Kalimi nga familja patriarkale në atë monogamë e ka një përgjegjës madhor dhe nuk ka qenë një proces evolutiv vetëm brenda familjes. Të pakten ndër shqiptarë ky proces njihet dhe përgjegjës për këtë ka qenë Institucioni Katolik i cili në Konkilin e Tivarit më 1199 ndaloi martesën brenda rrethit të shtatë

te trashëgimise (është një rast analog me pronen private cka con ne domosdoshmerine e pergjithesimit filozofik) cka tregon argumentueshem qe institucionet fetare jane pergjegjese per formen e sotme te familjes monogame. Raportet e ketyre institucioneve me formen e familjes na tregojne dhe kohen se kur jane shkruar qofte Bibla e qofte Kurani. Materializmi Filozofik duke pranuar zhvillimin si nderlidhes te Kohes, Hapesires dhe Levizjes kerkon medoemos vendosjen e nje parimi i cili formaton kete zhvillim dhe nuk fut ne kontradikte racat per efekt te kohes se ndryshme te zhvillimit. Ne kete pike ne gjejme argumentin me te plote te ligjit themelor te dialektikes mbi unitetin e te kundertave brenda zhvillimit, i cili tenton gjithmone e me shume t'i barazojë strukturat pjesmarrese deri ne momentin e permbysjes (kjo e fundit kur ndodh kerkon medoemos ndryshimin cilesor duke aprovuar pabarazine ne aktin e filleses). Ai qe lidh tre komponentet baze te natyres me kete zhvillim është pikerisht kontinumi kohor-hapesinor qe formon nje raport te barabarte me nje (1), prej nga rrjedh qe baza filozofike e zhvillimit shoqeror është shpejtesia e zhvillimit shoqeror e cila percaktohet nga Koha e lindjes. Eshte kjo shpejtesi qe ve dallimin midis popujve brenda nje race dhe është kjo bashkesi shpejtesish qe ve dallimin midis racave jashte rendeve shoqerore. Eshte pika me e pare dhe e rendesishme qe argumenton ekzistencen e parametrin: ndryshim i njeriut prej njeriut dhe menyren se si duhet analizuar Historia e Njerezimit ne vazhdim. Per kete problem është bere nje teorizim per mbi nje shekull, por me adresim te gabuar. Fjala është per "paradoksin e binjakeve" ose te "kohes", por me shkak-pasoje te gabuar, pasi ne qender te procesit nuk është shpejtesia qe percakton ecurine e kohes, por është koha e lindjes ajo qe percakton shpejtesine e zhvillimit dhe me kete merre fund e gjithë teoria e racizmit spekulativ. Mbi kete baze analiza e shoqerise shqiptare rezulton te jete shpjeguesja e filleses se Races se Bardhe ne kontinentin Evropian.

Materializmi filozofik duke pranuar heterogjenitetin si dukuri absolute te zhvillimit te Materies – Lendes – Shoqerise Njerezore, është i afte te shpjegoje ne menyre paraprake bazat e zhvillimit historik te Njerezimit jashte rendeve shoqerore ne perputhje me produktin shoqeror. Pra ate qe marksizmi nuk kishte marre per baze ne teorine e tij, ne sot e kthejme ne nje krah tjetër duke i dhene prioritet ligjeve te Natyres qe ndikojne mbi Shoqerine Njerezore dhe jo e kunderta (ketu qendron ndryshimi midis materializmit ne tendence dhe materializmit filozofik). Themeli i gjithë ketij teorizimi është shpejtesia e zhvillimit social qe parapercaktohet nga koha e lindjes. E perkthyer me kuptueshem rezulton qe popujt e vjeter kane shpejtesine e zhvillimit shoqeror me te avashte ne raport me popujt e lindur me vone, dhe rrjedhimisht jane me te prapambetur se keta te fundit. Te pakten rasti shqiptar ne Evrope duhet konsideruar sot rasti me tipik, por edhe ne kontinentet e tjera, ne kohera shume me te hershme, ndjehen diferencime ekstreme per shkak te kohes se lindjes se popujve (ne Azi, Japonia me pjesen tjetër te Races se Verdhe, Babilonia me pjesen tjetër te Races Malavjane; ne Afrike, Egjipti kundrejt Kartagjenes, dhe te dy keto popuj kundrejt popujve te tjere te Races se Zeze).

FAKTI me kryesor qe Materializmi Filozofik merr ne konsiderate si veprimtari thelbesore te Njerezimit është Bota e madhe e relacioneve Universale dhe është kjo veprimtari qe ka percaktuar te sotmen qe po jetojme. Pasoja me e rendesishme e kesaj bote është GJUHA dhe shumellojshmeria e saj tregon se kjo bote ka qene e diferencuar ne zhvillim qe ne ditet me te para te Njerezimit. Shkalla e diferencuar e zhvillimit te gjuheve është treguesja me e pare qe bartesit e tyre jane te cfaqur ne Histori ne menyre te deferencuar nga pikepamja kohore. Por ketu rendesi te posacme merr nje proces i konstatuar prej mbi nje shekull me adresim te gabuar: "Paradoksi i binjakeve". Procesi ne kete rast mbarat mbi vete ndikimin dualist dhe kjo ka qene nje dukuri e pa konstatuar nga A. Ajnshtajni (fizikanti e pranonte ne menyre te njeanshme kete proces duke mos marre parasysht ndryshimin e kohes mbi relatorin (ne kete rast te gravitetit). Karakteri dualist i procesit ne fjale është pergjegjes per te gjithë gjendjen sociale te popujve te Globit, por detyra e tij nuk ka mbaruar ende dhe ketu mbetet per te percaktuar permasen e aplikimit ne vazhdimin e kohes. Te pakten per Popullin Shqiptar ky proces ka qene vendimtar dhe kjo dallohet me KOHEN qe po kalon. Nga pikepamja autoktone Populli Shqiptar jeton ne nje gjendje shume me te avancuar se sa duhet te jetonte ne realitet dhe është ky shkak qe krizat ekonomike nderkombetare nuk ndikojne mbi te. Por kryesorja tek Populli Shqiptar është gjuha, si faktor lidhes me popujt e Evropes.

Dua te them qe ne fillim qe me prejardhjen e Gjuhes Shqipe është spekuluar pa fund. Ne te gjithë shkollat e arsimit te detyrueshem thuhet qe gjuhe shqipe rrjedh nga gjuha ilirishte dhe permendet fjalori i Frang Bardhit si fjalori me i pare i gjuhes shqipe te lidhur me latinishten. E kam te qarte qe kjo është shume me e vjeter se shkolla enveriste, por me habit fakti qe fjalori i Frang Bardhit qe ne kapak e quan gjuhen e shqiptareve gjuhe te epiroteve dhe fjalori mban daten 1635 (kur me 1702 At Fancesko Maria da Lece O.F.M e quan fjalorin e tij Dittionario Italiano – Albanese) dhe kerkush nuk ka thene nje fjale per kete ndryshim duke u nenkuptuar qe gjuha epirote është e njejte me gjuhen shqipe. Por kjo gje permbys, mbi te gjitha, nje perfytyrim te gabuar mbi prejardhjen e gjuhes shqipe dhe nje transformim propogandistik per shkaqe politike te "panjohura". Te gjithë studiuesit e gjuhes shqipe, te huaj dhe shqiptare, e kane pranuar pa doreza qe Fjalori i Frang Bardhit është i pari fjalor i gjuhes shqipe edhe pse autori titullin ja kishte vene Dictionarium latino-epiroticum (te gjitha keto gjenden ne parathenien e fjalorit me autor Mario Roques). Duke u nisur nga e njohura drejt te panjohures ne kemi mundesi te ndertojme rrugeformimin e gjuhes se sotme shqipe, pasi tani ajo është zgjeruar edhe nje hallke me tej duke ndrequr prejardhjen e afert te Gjuhes Shqipe. Ne kete menyre ekuacioni retrospektiv i Gjuhes Shqipe, te pakten ne keto 3000 vjet, është si me poshte:

shqip – epirotisht (1635) – (+) ilirisht – gjuha primitive

Interpretemi i ketij ekuacioni na jep mundesine te argumentojme gjenezen historike te Gjuhes Shqipe duke u nisur nga bota e relacioneve universale e paraardhesve te afert dhe te larget te shqiptareve. Ne kete rast ekuacionet duhet te jene te shumte dhe duhet te kene kete varesi kohore:

Gjuha primitive e banoreve autoktone + gjuha pellazge = Gjuha ilirisht (nga lashtesia deri ne shek. VII Para Kri.; – Stela e Lemnos). Eshte kjo arsyeja perse iliret shfaqen ne histori perpara heleneve: te paret rrjedhin ne menyre te

drejteperdrejte nga banoret autoktone, ndersa te dytet ne menyre te drejteperdrejte nga pellazget e ardhur, te tjetersuar nga relacionet me vendasit autoktone.

Gjuha ilirisht + gjuha pellazge dhe gjuha helene = Gjuha epirote (nga shek. VII Para Kri. – 1635 duke ekzistuar paralel me gjuhen e Ilireve; Fjalori i Frang Bardhit). Eshte kjo aresyeja perse iliret shfaqen ne kohe perpara epiroteve duke pasur karakter birerie me ta, por keta te fundit (iliret) ekzistojne pertej te pareve ne planin kohor dhe te dytet jane transformuar ne epirote ne saje te relatave te sterzgjatura me helenet te sapo dale nga bota pellazgjike.

Gjuha epirote + gjuhete evropiane dhe gjuhete otomane, perse, arabe = Gjuha shqipe (nga 1635 deri me sot; Fjalori i At Fancesko Maria da Lece O.F.M.).

Dmth kerkimin e lindjes se emrit shqiptar dhe Gjuhes Shqipe duhet ta kerkojme pas vitit 1635 deri me 1702.

Perfundime

Sot problemi shtrahet se kur nje shoqeri qe nuk ka zgjidhur sakte drejtimin e vet filozofiko-botekuptimor, nuk mund te realizoje dot nje progres pozitiv ne zhvillimin social te saj (marksizmi i proletareve, sipas formulimit bolshevik, e kerkonte kete domosdoshmerisht tek rendi shoqeror dhe shkallet e zhvillimit te tij pa marre parasysh ndryshimin e njeriut prej njeriut ne saje te botes se relacioneve te pavullnetshme per palen e prapambetur; duke e konsideruar menyren e lindjes se ideve tre ndryshme politiko-juridike, fetare, letrare, artistike, shkencore, etj sekondare dhe pa ndikim edhe pse zbulimi i kesaj menyre e kerkon medoemos tjetersimin e marksizmit nga pozicioni i materializmit). Eshte kjo aresyeja perse analiza e mendimit Filozofik Materialist na con ne perfundimet e meposhtme:

1 – Filozofia Materialiste eshte projekti shpjegues i jetes shoqerore ne Racen Njerezore, te cilen e konsideron si formen me te larte te organizimit te struktures Natyrore, qe e quajme Lende.

2 – Qe te mundesh te shpjegosh menyren reale, dmth materialiste, se si eshte formuar Gjuha Shqipe qe ne gjenezen e saj me te pare duhet t'i pergjigjesh pikesepari tre pyetjeve te lidhura me ZOTIN, menyren se si lind Feja dhe per cfare sherbejne Institucionet Fetare ne Historine e Njerezimit. Pa ditur te shpjegosh kete trinom ekuacional harrojemi se dini ta zbertheni permbajten dhe thelbin e Gjuhes Shqipe. Gjuha Shqipe eshte e vetmja gjuhe ne Evrope qe ka ne themel te vet eterit e Kishes Monoteiste Evropiane dhe eshte e vetmja gjuhe qe mund te ndiqet qe ne gjeneze edhe pse eshte me e vjetera, duke perbashkuar te gjitha stadet e zhvillimit te Shoqerise Njerezore. Gjuha Shqipe eshte "magazina historike" me e plote e Races se Bardhe dhe perbashkuesja e dy racave njerezore ne Historine e Njerezimit. Gjuha Shqipe eshte shenja e pare e unitetit racor dhe e te gjithes Njerezimit ne vazhden historike te tij. Gjuha shqipe eshte e vetmja gjuhe evropiane qe ka zhdukur dallimet midis racave dhe midis feve shume perpara se te aplikohet politika globaliste. Gjuha Shqipe eshte shenja e ekzistences se ZOTIT dhe e unitetit te Races Njerezore ne Toke. Gjuha Shqipe eshte e vetmja gjuhe ne Evrope qe argumenton se ZOTI ndikin mbi popujt dhe jo mbi individin.

3 – Qe te mundesh te shpjegosh gjenezen historike te Popullit Shqiptar pike se pari duhet te argumentosh parimin natyror te lindjes se Njeriut ne Toke dhe nga rrjedh ai. Se dyti duhet te percaktohet rrugefornimi i racave njerezore ne Toke dhe cila eshte baza ligjore e formimit te tyre.

Se treti duhen zbuluar menytrat dhe format e lindjes se ideve fetare, juridike, politike, shkencore, letrare, etj. Duhet percaktuar rrugezhyllimi i gjithseiciles dhe prej kujt varen ne menyre te drejteperdrejte. Prej ketej do te rezultojte dhe rrugezhyllimi i races Njerezore ne Toke dhe cfare i bashkon dhe i ndan racat ne Toke. Se katerti duhet zbuluar se cili eshte ndikimi i faktorit KOHE ne zhvillimin e Races Njerezore ne Toke dhe perse perbashkimi i dy racave (autoktonet e gadishullit Ilirik – race e bardhe me pellazget e ardhur – race malavjane) ka ndodhur perpara se te realizohet konsolidimi brenda nje race, akoma me tej perpara se te formoheshin popujt evropiane (e njetja siuate paraqitet edhe ne elemimin e races se kuqe nga ana e races se bardhe). Se pesti duhet argumentuar aresyeja perse kane levizur bashkesite njerezore, ne cfare rasti, ne cfare permase dhe ku tipikisht pasi rezulton te mos jete nje fenomen ligjor per ate kohe dhe per ate rend shoqeror. Se gjashti teoria dhe praktika e Rendeve Shoqerore ka nevojte t'i ndryshoje metodika e zberthimit duke ja nenshtruaq faktorit KOHE. Eshte e pamundur te sakesohet e ardhmja e Njerezimit jashte ketij faktori. Shkencat shoqerore kane nevojte per nje permbysje totale perpara se te vihen ne krye te jetes sociale te Njerezimit. Duhet permbysur parimi mijeravjecar i sundimit te Politikes mbi Historine dhe mbi kete baze te shkruajturit te Historise sipas interesit te triumfuesit. Pikerisht pse ka ndodhur keshtu e ashtequajtura shkence e historise eshte krejttesisht ne ajer dhe nuk ka asnje domethenie dhe ndikim te drejteperdrejte mbi Njerezimin. Dhe po te behen te gjithes keto sakesime do te shikohet se Historia e Popullit Shqiptar eshte krejt tjetere per tjetere me domethenie qe ndihmon politiken ne drejtim te aplikimit te saj si udheheqese e zhvillimit historik te tij. Eshte e pamundur dhe e pa realizueshme aplikimi i politikave aktuale si udheheqese ne drejtimin e Popullit Shqiptar. Ato do te cojne medoemos ne zhdukjen e tij, njesoj sic ndodhi me trakasit dhe maqedonasit kur ju nenshtruan politikave skllavopronare romake. Politika e sotme shqiptare po perserit pike per pike politikave evropiane te fillim eres kapitaliste evropiane dhe kjo nuk eshte gje e mire. Kontraktimi midis ketyre politikave dhe shkallet se zhvillimit shoqeror autokton nuk mund te coje ne zhvillimin e propoganduar, por ne tjetersimin e popullates shqiptare jashte progresit social dhe rrjedhimisht ne zhdukjen e tij.

4 – Sudiuesit shqiptare te sotem te te gjithes fushave jane teper-teper larg aplikimeve materialiste, dmth fitim punimet e tyre filozofike e shkencore pa arritur ne asnje perfundim konkret. Cdo punim duhet t'i nenshtrohet pyetjes: cfare perfitimi ka shkenca dhe cfare ka perfitimi ka Populli Shqiptar, meqenese cdo punim konvertohet ne para. Politika shqiptare e mijevjecarit te ri po kopjon pike per pike politiken evropiane te para 400 vjeteve ne drejtimin politik te popullit te vet pa e ditur perputhjen hapsinore dhe pasojen e ketij veprimi. Ate qe Evropa e para 4 shekujsh nuk e ka ditur per vete nuk eshte mire te aplikohet si nje veprim pozitiv politik; me se paku do te coje ne lindjen e nje revolte nga poshte, duke kopjuar revolucionin ne Vendet e Ulta te shek. te XVI-te. Padija marksiste po vazhdon akoma, si nje inerci sociale, tek intelijenca postkomuniste duke bashkepunuar me prejardhjen shoqerore te gjithseicilit. Koha do te tregojte se ku po

e con Popullin Shqiptar produkti intelektual enverist dhe postkomunist.

Tirane, me 08.05.2014